



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**VENDIM**  
**Nr. 288, datë 16.06.2026**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT TË GJYQTARES**  
**ZNJ. MAELA ALICANAJ NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË**  
**E KËSHILLTARËVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË KËSHILLIN E**  
**LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 308, datë 18.06.2024 “Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. Maela Alicanaj në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat deri në dy vite” me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. Maela Alicanaj në pozicionin “këshilltarit ligjor” në Njësinë e Këshilltarëve të Komisioneve të Përherhme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në fund të afatit të komandimit, më datë 21.06.2026.
2. Kthimin e gjyqtares znj. Maela Alicanaj në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. Maela Alicanaj sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**